



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

“ Për miratimin e raportit vlerësues përfundimtar mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”

Bazuar në urdhrin e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78 datë 18.02.2019 i ndryshuar, Grupi Ndërinstitucional i punës për vlerësimin dhe riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, pas përfundimit të konsultimit me palë të tjera të interesuara dhe pasi shqyrtoi propozimin e Ministrit të Drejtësisë dërguar me shkresën nr. 2809/2 prot dt. 27.05.2022, në mbledhjen e datës 1 qershor 2022,

VENDOSI :

1. Miratimin e raportit vlerësues përfundimtar mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi e pjesë përbërëse e tij.
2. Propozimin për riorganizimin e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nga njëzetë e dy gjykata të rretheve gjyqësore në trembëdhjetë gjykata të tilla, me kompetenca tokësore si më poshtë:
 - i. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Berat**, me seli në qytetin Berat dhe kompetencë tokësore në bashkitë Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar dhe Poliçan ;
 - ii. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Dibër**, me seli në qytetin Peshkopi dhe kompetencë tokësore në bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos;
 - iii. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Durrës**, me seli në qytetin Durrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Durrës, Shijak, Kavajë dhe Rogozhinë;
 - iv. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Elbasan**, me seli në qytetin Elbasan dhe kompetencë tokësore në bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd dhe Prrenjas;
 - v. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Fier**, me seli në qytetin Fier dhe kompetencë tokësore në bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnje, Divjakë dhe Mallakastër;
 - vi. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Gjirokastrë**, me seli në qytetin Gjirokastrë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull;
 - vii. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Lezhë**, me seli në qytetin Lezhë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin;

- viii. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Korçë**, me seli në qytetin Korçë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll dhe Pogradec;
 - ix. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Kukës**, me seli në qytetin Kukës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë;
 - x. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Sarandë**, me seli në qytetin Sarandë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë;
 - xi. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Shkodër**, me seli në qytetin Shkodër dhe kompetencë tokësore në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz;
 - xii. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Tiranë**, me seli në qytetin Tiranë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë dhe Krujë;
 - xiii. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm **Vlorë**, me seli në qytetin Vlorë dhe kompetencë tokësore në bashkitë Vlorë, Selenicë dhe Himarë.
3. Propozimin për riorganizimin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga gjashtë gjykata apeli, në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin Tiranë.
 4. Propozimin për riorganizimin e gjykatave administrative të shkallës së parë, nga gjashtë gjykata administrative në dy gjykata të tilla, me kompetenca tokësore si më poshtë:
 - i. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë **Tiranë**, me seli në qytetin Tiranë dhe kompetencë tokësore që përfshin rrethet gjyqësore, Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë.
 - ii. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë **Lushnje**, me seli në qytetin Lushnje dhe kompetencë tokësore që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë.
 5. Përcjelljen për miratim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të raportit vlerësues bashkë me propozimin e mësipërm për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave.

KRYETAR I GRUPIT TË PUNËS
ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
ILIR RUSI

